



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT  
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVA – URED PREDSEDNIKA

## **KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN**

Shtojca 1

### **Rekomandimet e takimit të katërt**

**19 mars 2013, Prishtinë**

1. Duke vlerësuar përparimin e arritur në përmbushjen e kriterëve afatshkurtëra që dalin nga Studimi i Fizibilitetit i Komisionit Evropian, të ndërmirren hapat bashkërendues me qëllim të arritjes së përparimit të vazhdueshëm në prioritetet si gjyqësia, reforma zgjedhore, reforma e administratës publike, Kuvendi, të drejtat e njeriut dhe çështjet e diskutuara në Dialogun e Strukturuar për Sundimin e Ligjit.
2. Institucionet përkatëse të vazhdojnë me funksionalizimin e mekanizmave bashkërendues për fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
3. Finalizimi i dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Integrim Evropian të përfundojë deri në qershor të këtij viti, duke siguruar konsensus të plotë me të gjithë akterët e shoqërisë kosovare të përfshirë në këtë proces. Strategjia do të ndihmojë në përshpejtimin e procesit të integrimit evropian duke përcaktuar qartë prioritetet, aktivitetet, përgjegjësitë dhe periudhën reale kohore.
4. Institucionet përkatëse të ndërmarrin hapat bashkërendues në përmbushjen e të gjitha kriterëve të mbetura dhe të kërkuara në Udhërrëfyesin për Liberalizim të Vizave dhe Planin e Veprimit për Liberalizim të Vizave, para përfundimit të këtij viti.
5. Në fushën e përafrimit të legjislacionit me *acquis*, fokusi të përqendrohet në fuqizimin e mekanizmave të ekspertizës ligjore dhe krijimin e një vije komunikimi me institucionet e BE-së për legjislacionin e caktuar.